



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.371/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Sanije Dubova nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat ZL.A.nr.371/2017, ZL.A.nr.372/2017, ZL.A.nr.373/2017, ZL.A.nr.374/2017, ZL.A.nr.375/2017 dhe ZL.A.nr.376/2017, e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Sanije Dubova nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 7 (shtatë) ankesa nga Sanije Dubova, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotimi Milloshevë nr.1502 e 01, 02 r, 03 D; në shkollën fillore “Ibrahim Rugova” Obiliq, Vendvotimi nr. 1501 e/01-1501 e/09 D etj; në Leskoshiq, Vendvotimi nr. 15; në Mazgit i Epërm, Vendvotimi nr. 15; në Dardhishtë, Vendvotimi nr. 15, në Breznicë, në vendvotimin 1503 c 01 r,02 D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.371/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i

supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hedh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses nuk e paragjykon çështjen se ankueses i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.371/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.